



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:170484

Datë: 22.11.2022

Numri i dokumentit: 03675406

P.nr.2021:170484

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit B. Z., nga Rahoveci, për shkak të veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë / Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.1046/2021 të datës 29.07.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të Shtetit Qazim Xharra i akuzuari si dhe e dëmtuara, më datë 11.11.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

B. Z., nga i ati B. dhe e ëma Xh., e lindur I., i lindur më ... në Rahovec, ku edhe tani jeton, me nr.p...., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i martuar i ati i dy (2) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i ndihmës sociale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me dt. 13.07.2021, rreth orës 23:50 minuta, në Rahovec, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri A. K., me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënie familjare shkakton dhunë në familje, gjegjësisht keqtrajtimin fizik të dëmtuarës-bashkëshortes së tij të dëmtuarës R. Z., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve në vazhdimësi në mes të pandehurit dhe të dëmtuarës, natën kritike i pandehuri pasi ka konsumuar alkool, derisa e dëmtuara ka qenë duke qëndruar me fëmijët e saj, i pandehuri në një moment i nervozuar fillimisht e shanë dhe e ofendon të dëmtuarën, e më pas e godet me grushta në pjesë të trupit, derisa vajza e tyre shkon në polici dhe paraqitet rasti, me çka të dëmtuarës i shkakton dhimbje fizike dhe cenim të dinjitetit të sajë.

-me çka ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40 par. 1 nënpar.1.3, 43, 46, 69, 70, nenit 248 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Dënimin me gjobë në shumën prej dy qind (200) euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntë dhjetë (90) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale..

E dëmtuara R. Z. nga Rahoveci, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari lirohet nga obligimet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike - shfrytëzues i ndihmës sociale.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër **PP/IL.nr. 1046/2021 të datës 29.07.2021**, kundër të akuzuarit B. Z., nga Rahoveci, për shkak të veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.11.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Xharra, i akuzuari dhe e dëmtuara.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, gjatë shqyrtimit fillestar ka lexuar aktakuzën duke qëndruar në tërësi pranë saj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, si dhe e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I akuzuari deklaroi se ka pranuar fajësinë sipas të gjithave pikave të aktakuzës, ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, pendohet për veprimin e bërë, i premtonte gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, pasi që kjo ka qenë momentale, ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe i ka parë fëmijët e vëllait i cili ka vdekur në aksident të komunikacionit të cilët janë jetim, ndërsa me bashkëshorten i kemi raportet të rregulluara dhe sot e kësaj dite jetojmë në harmoni, mirëpo i propozoi gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë, nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë pa presion, pasi që i ka kuptuar favorin dhe pasojat e pranimin të fajësisë, po ashtu duke i marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si ne dispozitiv të kësaj, ku edhe përmbushen elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari. I propozoi gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë nga

ana e të akuzuarit dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duhet të ketë parasysh si rrethanë posaçërisht rënduese faktin se vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare, si dhe i propozoi gjykatës që i akuzuari të obligohet në shpenzimet procedurale.

E dëmtuara R. Z. për ndryshe bashkëshortja e të akuzuarit ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit-bashkëshortit, si dhe nuk kërkoj kompensimin për dëmin e shkaktuar, pasi që raportet familjare i kanë të rregulluara e sot e kësaj dite jetojnë në bashkësi familjare pa asnjë problem.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari B. Z., me dashje e ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 248 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhje e kryen: “ **Kushdo që kryen dhunë ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.**”

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin B. Z. e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raporti i policit, të datës 13.07.2021;
- Deklarata e të dëmtuarës R. Z., e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me datën 13.07.2021;
- Procesverbali për marrjen në pyetje të miturës E. Z., në QPS në Rahovec me datën 13.07.2021
- Procesverbali për marrjen në pyetje të miturit B. në QPS në Rahovec me datën 13.07.2021
- Deklarata e të pandehurit B. Z. e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me datën 13.07.2021.

- Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është i gjendjes së varfër ekonomike, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38, dhe 48 i KPRK-së, dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile, bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi për lirim nga shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 453 par.4 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.2021/170484, me datë 11.11.2022

B. Profesional
Afrim Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.